REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

Kompania Regjionale e Mbeturinave/ Regional waste Company/ Regionalna Kompanija za Uklanjanja Otpada

KRM "PASTËRTIA" SH.A. FERIZAJ

Rr. "Enver Topalli" Nr. 47 Tël. 0290/325-025

KONKURS

- **Numri i referencës së pozitës së punës:** 2331 / 20
- **Titulli i pozitës:** Zv.Kryeshef Ekzekutiv në KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj (1)
- **Raportimi:** Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve të KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj
- **Mandati:** Zv.Kryeshefi Ekzekutiv emërohet nga Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj me mandat 3 (tre) vjeçar
- **Koeficienti i Pagës:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj
- **Vendi i Punës:** KRM "Pastërtia" Sh.A. Rr. "Enver Topalli" Nr.47, Ferizaj

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

- Në mungesë të Kryeshefit Ekzekutiv të njëjtin e zëvendëson në punët dhe detyrat e tij;
- Ndihmon Kryeshefin Ekzekutiv në organizimin dhe menagjimin e punëve të ndërmarrjes;
- Ndihmon zyrtarët e lartë të kompanisë në çështje të caktuara;
- Së bashku me Kryeshefin Ekzekutiv përcjell realizimin e Planit të Biznesit;
- Ndihmon në hartimin e planit të biznesit;
- Merr pjesë në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Angazhohet në koordinimin e punëve të sektorëve të kompanisë;
- Kryen edhe punë të tjera konform dispozitave ligjore të Ligjit për Ndërmarrje Publike, Statutit të kompanisë dhe rregulloreve në fuqi.

KUALIFIKIMI DHE PËRGATITJA PROFESIONALE:

- Të ketë përgatitje universitare;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në menaxhim;
- Të posedoj aftësi dhe shkathtësi profesionale për të punuar në mënyrë të suksesshme;
- Të ketë aftësi të larta komunikimi dhe bashkëpunimi
- Të ketë aftësi për të kryer detyrat e punës në situatë të qetë dhe nën presion;
- Njohës i mirë i punës me kompjuter.

KUSHTET PËR APLIKIM:

Kandidatët për Zv.Kryeshef Ekzekutiv KRM "Pastërtia" Sh.a Ferizaj duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Dëshmi për kualifikimin profesional / Diploma e Fakultetit (e noterizuar);
- CV-në;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit ose Çertifikatën e lindjes;
- Çertifikatën që nuk është nën hetime;
- Të mos ketë bërë shkelje të Kodit të Etikës për standarde dhe sjellje profesionale;
- Kërkesën për punësim (Formulari merret në zyret e KRM "Pastërtia" Sh.A Ferizaj);
- Deklaratën nën betim (Formulari merret në zyret e KRM "Pastërtia" Sh.A Ferizaj).

Aplikuesi duhet të përgatisë deklaratën nën betim, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbushë kushtet e kualifikimit, pavarësinë dhe përgatitjen profesionale, çdo përgënjeshtrim material, qoftë i qëllimshëm apo nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër përmendur, do të rezultojë me diskualifikim të menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në zarf të mbyllur dhe të dorëzohet në zyret e KRM "Pastërtia" Sh.A Ferizaj, çdo ditë pune nga 08:00 deri 16.00 Afati i konkursit për aplikim është i hapur 30 ditë kalendarik nga dita e publikimit në web-faqen e Kompanisë si dhe në shtypin ditor, duke filluar nga data **22.09.2020 deri më 21.10.2020 në orën 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni numrin e tel. 0290/325-025